UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Deklaratë nën betim

Unë, _____, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të
OE,_____, deklaroj nën betim, në emër të tij, se:

- Kam lexuar dhe pranoj kushtet e thirrjes publike për marrjen me qira dhe menaxhimin e bufesë së UIBM-së. Të dhënat dhe dokumentet e paraqitura në ofertë janë të sakta dhe të vërteta.
- Në rast të përzgjedhjes, operatori merr përgjegjësi për higjienën dhe sigurinë ushqimore gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përfshirë ruajtjen, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve e pijeve, si dhe kryerjen e vlerësimeve të nevojshme për operim.
- Operatori do të pajisë dhe inventarizojë hapësirën pa ndryshuar strukturën e objektit ose pamjen e jashtme; do të investojë në matësit e brendshëm të ujit dhe energjisë elektrike nën monitorimin e UIBM-së dhe do ta funksionalizojë bufenë brenda 60 ditëve të punës nga nënshkrimi i marrëveshjes.
- Operatori do të shërbejë të gjitha ushqimet dhe pijet e listuara në menynë e ofertuar dhe do të zbatojë çmimet përfundimtare të ofertës, me tatimet e aplikueshme. Çmimet do të ndryshohen vetëm me miratimin paraprak të UIBM-së dhe mbi rrethana të arsyetuara.
- Operatori do të ofrojë shërbim nga e hëna deri të shtunën, në orarin 07:00–17:00, me mbyllje të dielave dhe gjatë pushimeve kolektive të universitetit. Do të zbatojë ndalimin e pirjes së duhanit dhe të pijeve alkoolike në hapësirat e bufesë dhe nuk do të ofrojë ushqime apo pije të ndaluara në Kosovë.
- Operatori pranon mekanizmin e qirasë dhe shpenzimeve të shfrytëzimit sipas thirrjes dhe marrëveshjes përkatëse, si dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjes nga komisioni përgjegjës i UIBM-së.

Këtë deklaratë e jap me vullnet të lirë dhe me përgjegjësi për saktësinë e përmbajtjes së saj, si pjesë të dokumentacionit të aplikimit.

Emri dhe mbiemri: _____ Pozita: _____

Vendi dhe data: _____ Nënshkrimi: _____

Vula e operatorit ekonomik: _____